



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Procesverbali i Diskutimit publik me gartë “Buxhetimi gjinor”, 23.08.2022

Përfaqësuesi i Organizatës Sundimi Demokracisë në Kosovë, Rexhep Zeka e hapi diskutimin, duke ju uruar të pranishmëve mirëseardhje.

Përfaqësuesi i SDK-së theksoi se, ”Ne po vazhdojmë një projekt “Fuqizimi i mekanizmave për buxhetim përgjegjshëm gjinor”. Ky projekt financohet nga “Fondi i grave të Kosovës” dhe nga “Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë”.

Po ashtu, Zeka falenderoi administratën e Komunës së Podujevës për bashkëpunimin e realizimit të këtij debati dhe tha se ky dëgjim ka të bëjë me kërkesat e grave dhe vajzave që janë në adresim të nivelit komunal, për buxhetin e vitit 2023.

Nënkyetarja e Komunës se Podujevës, Marigona Lahu gjithashtu falenderoi gratë që ishin të pranishme për të diskutuar për buxhetin e vitit 2023.

Nënkyetarja Lahu, theksoi se u mbajtën edhe diskutime tjera publike rreth buxhetit të vitit 2023, mirëpo kryesisht kishin qenë të pranishëm burra. Prandaj, bashkë me organizatën, ”SDK” organizuan një debat publik vetëm me gra, duke u shprehur të gatshëm për cdo kërkesë apo propozim të pranishmeve.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani falenderoi gratë pjesmarrëse në debat për buxhetin e vitit 2023.

Drejtori Osmani, theksoi se është dëgjimi i shtatë, duke treguar se me këto dëgjime po fokusohen kryesisht për buxhetimin gjinor. Drejtori, po ashtu tregoi se buxheti për vitin 2023 është 27.406,567.00 euro, duke theksuar se krahasuar me vitet e kaluara buxheti për vitin 2023 ka një rritje të ndjeshme të buxhetit.

Drejtori Osmani, tha se prioritete të Komunës së Podujevës është çdo sektor, por si prioritete më të theksuara është sektori i arsimit, sektori kultrës dhe bujqësisë.

Ganimete Sejdiu, Podujevë- ishte e pakënaqur me ndarjen e subvencioneve sepse nuk ishte përfituese asnjëherë dhe kërkon që t'i sigurohen mjete bujqësore.

Xhemile Jupolli, Shajkoc- “ Kérkesa ime është me u ndërtu një kopsht për fëmijë, sepse gratë tani punojnë dhe kanë vështirësi në udhëtim t'i dërgojnë fëmijët në kopshte në Podujevë.

Selvete Hamiti, Bajqinë- “ Kérkesa ime që të sjellni ujësjellsin në fshatin Bajqinë, sepse po kemi probleme që uji nuk është i pijshëm”.

Naim Bajrami, Orllanë, Përfaqsues i Rrhetit të Grave, - “Kérkesa ime është të shqyrtohet për ndërtimin e një kopshti, kérkesë për mjete të përpunimit të perimeve dhe ndërtimi i një sallë të sportit për gratë dhe vajzat”.

Ganimete Sejdiu, Podujevë- “Kam edhe një kérkesë për transport publik për fëmijët sepse në lagjën ku jetojë unë tek pishat nuk ka transport publik dhe fëmijët janë gjithmonë të rrezikuar nga qentë endacakë. Po ashtu, kérkojë te sillen mjete për analiza gjinekologjike .”

Fahrije Mhemeti, Podujevë- “ Kérkesa ime është për transport publik, sidomos për fëmijë sepse janë të rrezikuar nga qentë endacakë”.

Elhame Jupolli, Shajkoc- “Në projekt janë kanë me u shtru në asfalt disa rrugë, mirëpo janë anular. Po ashtu, edhe dritat dhe kanalizimet janë në projekt, por të gjitha janë anuluar”.

Shehide Restelica, Podujevë- “Merrem me turshi qe 7 vite dhe nuk kamë marrë përkrahje nga askush. Kérkesa ime është të më siguroni një pasterizues dhe po ashtu një serrë.”

Bahrije Jashari, Dumnicë e Poshtme- “Kemi nevojë për transport publik, për në Dumice të Epërme dhe i kemi fëmijët e rrezikum për me shku në shkollë. Po ashtu, ka nevojë edhe për çerdhe sepse punojnë shumë nëna.”

Xhemile Jupolli, Shajkoc- kërkon sqarime për panairin që ka dështuar me datën 3 gusht.

Xhemile Jupolli, Shajkoc- “Kishte me qenë mire me i organizo komuna edhe panaire të tjera, në fund të shtatorit apo fillim të Tetorit, kur është koha e turshive, sepse kur e kemi mbajt panairin e kalum jemi nda shumë të kënaqura”.

Nënkyetarja Lahu, “Xhemile ju frymëzoni pozitivitet dhejeni një grua shumë e zonja dhe jam shumë e lumturë që ju njohë tash nga afër. Ndërsa sa i përket panaireve, ne do të organizojmë panaire çdo herë që ju jeni të gatshme dhe jam shumë e lumtur që jeni nda të kënaqura edhe ju me panairin e datës një dhe dy gusht”.

Ndërsa, sa i përket panairit të datës tre dhe katër, Nënkyetarja Lahu, tregon se ka ndodhur një keqkuptim me FSK-në. Sepse, Komuna e Podujevës ka pas një bashkëpunim për marrjen e tendave gjatë atyre dy ditëve, por ka pas një keqkuptim dhe tendat janë sjellë me vonesë dhe për shakak të mos interesimit të biznevseve kanë dështu dy ditët e fundit.

Lahu, po ashtu theksoi për çështjen e Pap Testit se Komuna është duke punuar drejt finalizimit të kësaj çështje dhe shumë shpejt do të jetë i gatshëm për shërbim, sepse tash Mamografi është

aktiv për shërbime. Ndërsa, sa i përket serrave, theksoi se tashmë është i hapur afati për aplikim, ku përfituese të këtij subvencionii do të zgjedhen 9 gra.

Po ashtu, Nwnkryetarja Lahu, theksoi se pavarësisht që është vetëm viti i dytë ne qeverisje dhe për një periudhë të shkurtë, besoj që për gratë e Podujevës kemi bërë shumë më shumë se vitet 20 vitet e kaluara. Kshtu që, kemi shumë projekte të mira për gratë, por gjera e mirë vinë ngadalë, mirëpo besoj që po i vreni edhe ju përmirësimet që po bëhen çdo ditë.

Banore e fshatit Llaushë- shprehë shqetësimin përrymën e dobët që është në fshatin Llaushë. “I kemi dy probleme në fshatin Llaushë përrymë dhe atëherë kur nuk kemi rrymë, kemi probleme edhe me ujë”.

Naim Bajrami- “Kishte me qenë mire edhe në fshatinë Orllan, me realizu një projekt për ndërtimin e një sallë, ku mbahen trajnime përrobaqepësi përgatitjen e ëmbëlsirave.

Drejtori Osmani- U përgjigjet grave përkérkesat dhe shqetësimet që i kanë. Ku, tha se në fushën e bujqësisë do të ketë dyfishim të subvencionimeve në vitin 2023. Në këtë vit janë subvencionuar serra më shumë se çdo herë tjetër, diku rrëth 152 serra janë dhënë nga Komuna e Podujevës, rrëth 70 serra janë në bshkëfinancim me Katarin. Ndërsa, sa i përket çështjes së çerdheve nuk ka ndonjë planifikim përrim 2023, në këto fshatra. Ndërsa në këtë vit do të inicohen 3 çerdhe dhe po ashtu në fshatin Lluzhan do ta kemi çerdhen e katërt. Gjithashtu, shkolla e vjetër në fshatin Sfeqël, do të renovohet dhe do të kthejmë në çerdhe, nëse nuk mundemi me përfundu në vitin 2022, do të vazhdojmë edhe gjatë viti 2023.

Kurse, në buxhetin e vitit 2023-2025 kemi mjete të shumëfishuara për planifikim për ndërtimin e ujësjellsit.

Drejtori Osmani, theksoi përrafiq urban Komuna është ne fazën e hartimit për themelimin e një ndërmarrje të re publike komunale, ku gjatë këtij viti besoj që do t'i përfundojmë proceduwart përkëtë ndërmarrje.

Gjithashtu, për personat të cilët janë në gjendje të rëndë shëndetësore do të i'u ofrohen shërbime në shtëpi.

Nënkyetarja Lahu, theksoi se Komuna e Podujevës në bashkëpunim me nivelin qëndror kanë ndarë 165,000 euro, për ndërtimin e një qëndrimi ditorë, për personat e moshuar, ku pritet që do të realizohet ky projekt në vitin 2023. Kurse, sa i përket rrobaqepësisë do të mbajmë trajnime, ku kemi një memorandum bashkëpunimi me një organizatë, por do të mbahen në lokacione të ndryshme.

23 gusht, Podujevë



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Diskutim publik me gratë "Buxhetimi Gjinor" 2023
Komuna e Podujevës në bashkëpunim me OJQ "SDK"

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr.telefonit	Nënshkrimi
1	Xhemije gjylli	SHAIKOFĆ		Xhemije gjylli
2	Selvete Hamiti	BAJFIN		Selvete Hamiti
3	Mirzige Crash	Dobiqdol		Mirzige Crash
4	SHAKRIO NEZIRI	BRADASH		SHAKRIO NEZIRI
5	ELIFE BIJACA	PODUSEVE		ELIFE BIJACA
6	SHEHIDE RESTELICA	PODUSEVE		SHEHIDE RESTELICA
7	FITNETE HALIMI ALIU	PODUSEVE		FITNETE HALIMI ALIU
8	SAHADETE SHABANI	BAJQINIE		SAHADETE SHABANI
9	FAHRIJE MEHMETI	Podujeve		FAHRIJE MEHMETI
10	KADA NEHMETI	Podujeve		KADA NEHMETI
11	ELHAME JUPOLLI	SHAIKOVĆ		ELHAME JUPOLLI
12	SHEMSIE JUPOLLI	SHAIKOVĆ		SHEMSIE JUPOLLI
13	DASHURIE JUPOLLI	SHAIKOVĆ		DASHURIE JUPOLLI
14	Bubulina Peçi	Prishliri		Bubulina Peçi
15	Bahrija Vashani	Dumnicë		Bahrija Vashani
16	Fikruj Gururku	Podujevi		Fikruj Gururku
17	Selvete Sajdiu	Podujeve		Selvete Sajdiu
18	RGXHET TGA	ORICAN		RGXHET TGA
19	MARTE FETAT	Podujeve		MARTE FETAT
20	Najme Podujeve	Podujeve		Najme Podujeve
21	Nolam Bajrami	OCEAN		Nolam Bajrami
22				
23				
24				

25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				

Podujevë

23.08.2022

